Për informacione të mëtejme apo një bisedë ndërmjetësuese drejtohuni në njërën nga këshillimoret në vijim:

Martesa dhe kurorëzimi në Zvicër
Fletë informacioni për prindërit

Këshillimoret, që janë të afërta me të dy kulturat janë:

- www.zwangsheirat.ch – kontaktimi i parë përmes E-Mail-it
- Ausländerdienst Baselland ald, Tel : 061 827 99 10
- GGG Ausländerberatung (Basel Stadt), Tel: 061 206 92 22
- Këshillimoret për qiftet binacionale dhe familjet, Tel: 061 271 33 49

Këshillimoret familjare:

- Kantoni Basel-Stadt: Këshillimorja për familje dhe qifte dhe edukim, Tel: 061 686 68 68
- Kanton Basel-Land: Adresat e autorizuara mund t'i gjeni në faqen elektronike www.fejb.ch apo mund të drejtohuni pranë Ausländerdienst Baselland ald

Në raste urgjente:

- Thirrja e policisë, Tel: 117
- Ndihma e viktimave të dy Bazeleve, Tel: 061 205 09 10

A ndodheni përpara një situate të vështirë dhe a mendoni mbi të ardhmen e fëmijës tuaj? Në faqet në vazhdim gjeni informacionet mbi temat e martesës dhe kurorëzimit në Zvicër si dhe adresat e rëndësishme të kontaktimit.

GGG Ausländerberatung

ald Ausländerdienst Baselland

PROJEKTE GEGEN ZWANGSHEIRAT

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Mbështetur nga krediti federal për integrim (BFM)

Me mbështetje miqësore të www.zwangsheirat.ch

Albanisch

«Gjëja kryesore djemtë tanë martohen njëherë nga dashuria:»
(Davide Maniscalco, 45, i lindur në Sizili, prej 17 vitesh në Zvicër, dhe Helen Maniscalco-Schwarzentruber, 41, e lindur në Bazel)

Baza ligjore në Zvicër

Kurorëzimi është i mundur vetëm nga mosha 18 vjeçare: Vetëm kur të dy partnerët lënë pas vitin e tetëmbëdhjetë të jetës mund të lidhin kurorë.

Secila dhe secili mund të zgjedhin të lirë partneren apo partnerin e vet, askush nuk lejohet të detyrohet për lidhjen e kurorës.: Kurorëzimi bazohet në vullnetin e lirë të dy partnerëve. Për një kurorëzim të detyruar flitet kur njëri apo të dy partnerët nuk kanë mundësi të refuzojnë kurorëzimin.

Të drejta të barabarta për burrin dhe gruan në të gjitha fushat.: Gruaja ka të drejtë vendimmarrje sikur burri, mendimi i saj ka peshën e njëjtë me atë të burrit.

Çdo grua dhe çdo burrë ka të drejtë të shkurorëzohet/prishë kurorën: Përmes divorcit mund të prishet kurorëzimi. Nëse të dy palët bashkëshortore dëshirojnë të ndahen, mund të kërkojnë divorcin bashkërisht pranë gjykatës. Nëse dëshiron vetëm njëri person të ndahet atëherë mund të parashtroj në gjykatë kërkesën për divorc.

Në kultura tjera vlejnë pjesërisht baza tjera ligjore dhe tema «Martesa dhe kurorëzimi» ka një trajtim tjetër, megjithatë në Zvicër vlejnë rregullat e përmendura më lart. Për këtë arsye shpesh përplasen botëkuptime të ndryshme kulturore duke pasur parasysh kurorëzimin dhe lidhjen e kurorës, megjithëse prindërit dëshirojnë zgjidhjen më të mirën për fëmijët e tyre.

Të dashur prindër,

Më vjen shumë rëndë të shkruaj këtë letër pas një kohe aq të gjatë. Divorci (ndarja) jonë më sjell shumë dhimbje dhe më duhet të kaloj shumë net pa gjumë. Për mua është e qartë, që edhe ju mendoni çdo ditë për mua: ndoshta të zemëruar, të zhgënjyer dhe sigurisht të brengosur. ***Unë e di që ju dëshironi zgjidhjen më të mirë për mua dhe unë ju dua ju pa masë, mirëpo unë nuk mundem dhe nuk dua të martohem ne një burrë që nuk e dua.***

JU lutem mos u zemëroni me mua! Ju më keni shoqëruar gjatë fëmijërisë dhe rinisë time, tani më duhet të gjejë rrugën vetë. Kjo rrugë është ndoshta për ju e pakuptim, mirëpo një ditë do të krenoheni me mua, këtë ju premtoj unë. ***Uroj fort nga zemra, që njëherë të takohemi pa zemërim dhe me kënaqësi. Nëse do të kisha mundësi sërish të zgjidhja do të vendosja sërish për ju si prindërit e mi.***

Me dashuri, vajza juaj

«Unë nuk jam kundër traditës. Por kundër kurorëzimit të detyruar.»
(Şheriban Akyıldız, 36, me prejardhje nga Turqia.
Medya, 13, dhe Arya, 7, të lindura në Zvicër.)

«Vajzat e mia zgjedhin vetë. Për mua kjo është e rëndësishme.»
(M. Hassan Rahimifar, 59, erdhi në vitin 1998 nga Irani në Zvicër.
Elnaz, 21, dhe Eliza 16, jetojnë nga viti 2000 në Zvicër.)